

FJALA E DEPUTETES ALBANA VOKSHI

E ENJTE 4 NËNTOR 2021

Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar qytetarë,

Shqipëria është e fundit në rajon dhe në Europë në çdo tregues social, pra në shëndetësi dhe arsim. Në Shqipëri asgjë nuk funksionon mirë. Edhe për vaksinimin, në epokën e re të ministres Manastirliu, jemi të fundit; qeveria dhe ministria kanë dështuar. Asgjë nuk funksionon, sepse Kryeministri e ka mendjen të mbrojtë nga ndëshkimi njeriun, të cilit i dha tenderë sekretë gjatë pandemisë. Në një vend normal kjo nuk do të ndodhte. Shikojeni këtë foto! Është bërë mbrëmë në mes të Beogradit. Shikojeni logon në çadrën e Kryeministrit! Kjo është provë për lidhjen direkt të Edi Ramës me mafien e ilaçeve. Kjo tregon që askush nuk jep tenderë sekretë pa dijeninë e tij dhe pa përcaktuar paraprakisht se kush do t'i marrë ata. Sa për kujtesë të tenderëve sekretë, kjo kompani që Edi Rama ka si logo në çadrën e tij, i ka shitur qeverisë maska e pajisje mbrojtëse me 3 ose 5 herë më shumë se tregu i çmimit me pakicë. Sot pronari saj është në arrest për kontrabandë ilaçesh. Me këtë foto Edi Rama tregon se korrupsioni i vërtetë fillon e bëhet në zyrën e tij, ndaj SPAK-u duhet ta marrë menjëherë në pyetje atë.

Të dashur qytetarë,

Sot edhe unë doja ta hapja fjalën time me rastin, i cili sot duhej të ishte bërë një kampion alarmi për të gjithë prindërit dhe shoqërinë shqiptare. Ndërkohë që gjithë shqiptarët merren me politikën e madhe, politikën e ditës, me PDnë, me PS-në, me LSI-në, me foltoren e të tjera; ndërkohë që çdo ditë në shkallët e Kryeministrit apo në komisionet parlamentare ministrat flasin për arritjet spektakolare të Edi Ramës dhe qeverisë; ndërkohë që 51% e shqiptarëve dhe 53,9 % e fëmijëve deri në 18 vjeç jetojnë në kushtet ekstreme të varfërisë, siç evidentohet edhe në raportin e fundit të Eurostatit, ne po harrojmë disa çështje të rëndësishme, çështje jetike, po harrojmë të flasim aq sa duhet për sigurinë e fëmijëve tanë në shkollë, po harrojmë të bërtasim fort për të mbrojtur fëmijët tanë. 4 herë radhazi ministrja e Arsimit, zonja Kushi, ka refuzuar të vijë në Komisionin parlamentar të Shëndetësisë për të raportuar për masat që ajo ka marrë për përballimin e pandemisë në shkollë dhe në dy javë e ka shkelur 4 herë Kushtetutën. A e dini se cila është më qesharakja?! Ajo e ndiqte live mbledhjen e komisionit. Pra, ministrja nuk guxonte të përballej me komision, por e ndiqte live nga zyra e saj. Pra, kohë kishte, por nuk kishte dëshirë. Lind pyetja: çfarë e shtyn ministren Kushi të refuzojë komisionin dhe kush i jep asaj guximin që të shkelë Kushtetutën? Mbrojtësi i vetëm i shkelësve të Kushtetutës në këtë sallë është Edi Rama. Arsyeja e refuzimit është dështimi në arsim në çdo aspekt, si: në cilësinë e arsimimit me buxhetimin, me investime, infrastrukturë, në trajtimin me respekt dhe dinjitet të mësuesve, dështimi edhe në menaxhimin e pandemisë. Shqipëria sot është në këtë gjendje, sepse Edi Rama nuk e do arsimin, nuk i pëlqejnë të arsimuarit, nuk e ka pasur dhe nuk do ta ketë ndonjëherë prioritet atë. A e dini cili është dështimi më i madh? Është siguria e fëmijëve në shkollë. Shifrat janë alarmante. Janë 81 raste dhunimi në shkollë në periudhën prill – qershor 2021, askush nuk flet për këto, ndër të cilat 44 raste janë dhunë seksuale.

Çfarë u bë me programet e policimit në shkolla, e cila u trumbetua aq shumë nga Rama, Nikolla, Shahini, Kushi e të tjerë? Sistemi ka dështuar. Para pak ditësh një ngjarje e rëndë, që e përmendën edhe kolegët e mi, ka ndodhur në Kamëz. Një vajzë 6 vjeç është dhunuar nga i ati. Rasti nuk është referuar nga drejtori i shkollës në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve, nuk është referuar as në polici, vetëm falë një mësueseje, e cila ka bërë me përkushtim detyrën e saj, rasti është referuar privatisht në Zyrën Arsimore Vendore. Institucionet kanë qenë në dijeni prej muajsh, por asnjëri nuk ka reaguuar për ta referuar rastin e vajzës. Askush nuk e bëri punën e tij siç duhet dhe kjo është rrëqethëse. Në një rast të tillë Kryeministri duhej ta kishte shkarkuar menjëherë ministren Kushi, sepse sistemi arsimor nuk po i mbron fëmijët tanë. Asgjë nuk funksionon. Sistemi i Referimit për Mbrojtjen e Fëmijëve është rrëzuar dhe nuk funksionon, pra ka dështuar dhe për këtë dështim mban përgjegjësi ministrja Kushi, e cila as tani nuk është në sallë, sepse nuk guxon të përballet me të vërtetat e hidhura. Unë kërkoj hetim urgjent profesional të rastit të Kamzës, por dehe të çdo rasti tjetër dhunimi. Fajtorët duhet të çohen menjëherë përpara drejtësisë, duhet shkundur sistemi për të ndërtuar një mekanizëm referimi për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje. Kërkoj që të ngrihet menjëherë nënkomisioni për çështjet e grave dhe të fëmijëve, si dhe do t'i kërkoj komisionit që unë drejtoj një dëgjësë urgjente me gjitha institucionet që kanë përgjegjësi mbrojtjen e fëmijëve. Të dashur qytetarë, Sot po diskutojmë për një tjetër amendament të marrëveshjes së qeverisë me kompaninë Pfizer për një sasi tjetër, më shumë se 500 mijë vaksinash. Po ku jemi me menaxhimin e saj? Ashtu si me menaxhimin e pandemisë COVID-19, edhe ky proces, pa asnjë mëdyshje, është një nga dështimet më të mëdha të qeverisjes "Rama". Kjo jo vetëm për shkak të numrit të lartë të viktimave, por edhe për shkak të nivelit më të ulët të vaksinimit në rajon dhe në Europë.

Sot Shqipëria ka nivelin më të lartë të vdekshmërisë në rajon dhe në Europë. Më lejoni t'ju risjell në vëmendje këtë grafik. Shikoni Shqipërinë me 27,1%. Kjo, ashtu si e evidenton edhe raporti i KLSH-së, ndodh për shkak të keqmenaxhimit të pandemisë nga ana e qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Janë mbi 16 mijë jetë të humbura, në krahasim me periudhën 2016 – 2019, më shumë se dyfishi i mesatares së Europës dhe niveli më i lartë në rajon. Vetëm në muajin tetor kanë humbur jetën më shumë se 200 njerëz, ndërsa ka zëra që numri i viktimave është akoma më lartë. Këtij dështimi i qëndron si aureolë menaxhimi i vaksinimit, i cili, përveçse është një spektakël propagande nga Kryeministri, Ministria e Shëndetësisë, nuk ka rezultuar aspak efektive. Ja ku i keni shifrat! Ne jemi të fundit me 31% me 2 doza dhe 44% me një dozë; me 2 doza Maqedonia e Veriut 37%; Mali i Zi 39%, Serbia 44%, Kosova 41% (është 10 pikë përçindje më lart se Shqipëria) Greqia 62%; Italia 72%; Bashkimi Europian 65% dhe niveli botëror është 39%. Pra, jemi shumë më ulët edhe se niveli botëror, jemi të fundit. Skandali nuk ndalet. Me porosi të ministres Manastirliu mjekët urdhërohen të braktisin pacientët në qendrat shëndetësore dhe të shkojnë në "Air Albania". Ky është krim. Si mund t'u kërkosh mjekëve që të braktisin misionin e tyre për të shkuar për një show propagandistik në "Air Albania"? Cili ministër i përgjegjshëm e bën këtë? Askush, përveç ministres Manastriliu. Pasi nxora postimin në Facebook, filloi linçimi i mjekëve për të marrë vesh se kush ka nxjerrë mesazhin dhe porositë e Ministres.

"Rilindja" e përcolli ritualin e vaksinimit me sloganin "Shqipëria buzëqesh", por në realitet shqiptarët vajtojnë ende pasojat afatgjata të kësaj pandemie, vuajnë shpirtërisht dhe moralisht për të dashurit dhe familjarët e humbur nga COVID-19, vajtojnë borxhet e jashtëzakonshme dhe shkatërrimin ekonomik që u shkaktoi kjo sëmundje. Vetë ministrja në komision pranoi se nga 183 mijë të prekur nga COVID, vetëm 7500 janë rimbursuar, pra vetëm 4%. A dini kujt ia vuri fajin? Mjekëve të familjes.

Nga shpenzimet mesatare për pacient, që shkonin rreth 1000 dollarë, janë rimbursuar vetëm 40 dollarë, 960 prej tyre janë të pambuluara. A e dini se kujt ia hodhi fajin ministrja për këtë? Ua vuri fajin qytetarëve. Shqiptarët janë braktisur nga qeveria, por kjo braktisje ka kosto të lartë financiare dhe humane, por për këtë fajin, sipas ministres, e ka opozita! Për dështimin nuk flet vetëm opozita, por flasin shifrat tejet të ulëta të të vaksinuarve, flasin ekspertët e pavarur, dëshmojnë mjekët dhe stafi i shëndetësisë në terrenin ambulator e spitalor, dëshmojnë njerëzit e moshave dhe kategorive të ndryshme sociale. Për dështimin flet braktisja totale që u ka bërë qeveria mjekëve dhe mësuesve. Qindra mesazhe më kanë ardhur nga mësues, të cilët sot japin mësim në shkolla pa infrastrukturë. Qindra mesazhe kam marrë nga prindër, të cilët i dërgojnë fëmijët e tyre në shkolla në kushte transporti pa standarde. Të dashur qytetarë, Sot në rend të ditës kemi një tjetër akt normativ. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta votojë pro këtë marrëveshje dhe çdo marrëveshje që mbron jetën e shëndetin e qytetarëve.